

TË PROMOVOJMË SHËNDETIN QË NË MOSHËN MË TË RE



Burime në dispozicion të prindërve
që kanë fëmijë të vegjël
në kantonin e Neuchâtel-it

Albanais

Broshurë* për prindërit me fëmijë të vegjël



Promovimi i shëndetit përfshin krijimin e kushteve që mundësojnë adoptimin dhe ruajtjen e mënyrave të jetesës, të cilat janë të favorshme për shëndetin. Fëmijëria e hershme është koha më e mirë për ta praktikuar një gjë të tillë. Që në periudhën e shtatëzanisë, ashtu edhe gjatë muajve dhe viteve të para të jetës së tyre, fëmijët përjetojnë një rritje dhe zhvillim shumë të shpejtë, i cili kushtëzohet nga mjedisi në të cilin rriten. Këto eksperiencë janë vendimtare për shëndetin e tyre gjatë gjithë jetës (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2009).

Në kantonin e Neuchâtel-it janë angazhuar disa organizata, të cilat promovojnë shëndetin e fëmijëve nga 0 deri në 4 vjeç. Ato ofrojnë shërbime të ndryshme dhe qëndrojnë në dispozicion të prindërve për çështjet që lidhen me zhvillimin, shëndetin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre.

Shërbimi i Shëndetit Publik ka vendosur realizimin e kësaj broshure për tu mundësuar prindërve njohjen sa më mirë të këtyre burimeve si dhe qasjen më të lehtë ndaj tyre.

*Broshura është në dispozicion jo vetëm në gjuhën frënge por edhe në shumë gjuhë të tjera. Ajo mund të komandohet ose të shkarkohet në versionin elektronik në faqen e internetit www.ne.ch/promotionsante.

Përmbajtja

Profesionistët e shëndetit

Mjekët peditër	4
Mamitë	4
Spitalet e Neuchâtelit – maternitetet	5
Qëndrat e shëndetit seksual-planifikimi familiar	6

Shërbimet e specializuara

Qendrat për kujdesin ndaj fëmijëve të Kryqit të Kuq	7
Zyra për mbrojtjen e fëmijës	8
Fondacioni Carrefour, AEMO nga 0 deri 18 vjeç	9
Shërbimi psiko-edukativ i Kryqit të Kuq	10
Shërbimi Edukativ Shëtitës	11
Qendra psikomotorike	12
Qendra psikiatrike e Neuchâtelit – Fëmijëria dhe Adoleshenca	13
Shërbimet në ndihmë të familjeve të emigruara	14

Pranimi dhe shërbimet për kujdesin ndaj fëmijës

Shërbimi i Ruajtjes së Fëmijëve në Shtëpi i Kryqit të Kuq	15
Qendra e pranimit prindër fëmijë	16
Qendra ditore	17

Adresa të tjera të nevojshme

18

Numrat e urgjencës

20

Profesionistët e shëndetit

Mjekët peditër

Mjeku peditër është profesionisti ku duhet të drejtoheni për çdo problem që ka të bëjë me shëndetin e fëmijës tuaj. Ai e ndjek fëmijën tuaj gjatë gjithë periudhës së rritjes e për këtë arsye, me të mund të vendoset një mardhënie mirëbesimi. Mos hezitoni t'i drejtoni pyetje në rast nevoje.

- ▶ Ju mund të gjeni në faqen internet www.ne.ch/autorites/DFS/SCSP/Pages/NeMedReg.aspx një listë mjekësh e veçanërisht peditrësh të autorizuar në kanton.

Mamitë

Mamitë ofrojnë mbështetje, këshilla dhe kujdes për gratë gjatë periudhës së shtatzënisë dhe gjatë lindjes. Ato punojnë nëpër spitale ose praktikojnë në mënyrë të pavarur. Mamitë ofrojnë në veçanti konsultime shtatëzanie, ndjekin mbarëvajtjen e barrave që janë me rrezik dështimi si dhe përgatisin nënat për lindje. Ato i praktikojnë lindjet në spitale, në shtëpi apo në maternitetet. Gjatë periudhës së paslindjes, ato i shoqërojnë nënat në mësimin e dhënies së gjirit si dhe përkujdesen për të porsalindurit dhe foshnjat. Mamitë luajnë një rol, gjithashtu, në drejtim të higjenës, të edukimit dhe ofrojnë kurse të ndryshme (masazh, mbartje, etj). Për të gjetur një mami në zonën tuaj, vizitoni faqen e mëposhtme të internetit ose konsultohuni me mjekun tuaj.

- ▶ Association des sages-femmes à domicile, Neuchâtel (ANSFD)
Case Postale 34, 2052 Fontainemelon, 079 280 48 28

- ▶ Fédération suisse des sages-femmes
www.hebamme.ch

Kostoja e shërbimeve: Pjesa më e madhe e shërbimeve të bëra nga mamite do të kompensohet nga sigurimi bazë(LAMal). Në faqen internet të Zyrës federale të shëndetit do të gjeni informacione të detajuara publike (OFSP), www.bag.admin.ch (temat «Assurance-maladie», më pas «Prestations» dhe zgjidhni «Prestations en cas de maternité et de naissance» ose «FAQ», filtër nga temat «Assurance-maladie», filtër nga nën temat «Prestations en cas de maternité»).

Spitali neuchâtelas – materniteti

Gjatë shtatzënisë, ekipi i maternitetit ofron konsultime për shtatzëninë, seanca të përgatitjes për lindje si edhe konsultime që kanë të bëjnë me akupunkturën dhe hipnozën. Po ashtu, mundëson një bisedë një-orëshe me njërën prej mamive për përgatitjen e planit për lindjen. Në rast se gjendja familjare është e rëndë dhe kërkon marrjen e masave të tjera, ka këshilltare mami që janë në dispozicion për të ofruar mbështetje dhe këshilla. Gjatë lindjes së fëmijës, përveç kujdesit mjekësor, çdo gruaje i ofrohet një ndjekje e personalizuar si dhe alternativa si akupunktura, vaska, masazhi dhe pozicione të tjera për të lindur. Shoqërimi i personalizuar vazhdon gjatë gjithë qëndrimit në maternitet, pas lindjes si dhe duke i rrethuar prindërit me këshilla e kujdes gjatë krijimit të përvojës së re me foshnjën e tyre. Pas kthimit në shtëpi, materniteti mund të kontaktohet në çdo moment nëse është e nevojshme.

Hôpital neuchâtelois
Pourtalès, Maladière 45, 2000 Neuchâtel, 032 713 33 07
www.h-ne.ch/hospitalisation-sejour-maternites-pourtalles

Kostoja e shërbimeve: tu referoheni kushteve për rimbursimin e shërbimeve nga sigurimi bazë (LAMal).



Qëndrat e shëndetit seksual-planifikimi familiar **Centres de santé sexuelle-planning familial**

Qëndrat e shëndetit seksual-planifikimi familiar ofrojnë shërbime informacioni, udhëzime dhe mbështetje për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin seksual, të tilla si: seksualiteti, kontracepsioni, shtatzënia e planifikuar ose jo, infeksionet seksualisht të transmetueshme, orientimit seksual, dhuna, fertiliteti, etj.

Ato janë të hapur për të gjithë, pavarësisht nga mosha, gjinia, statusi martesor, feja, kombësia apo orientimi seksual, në mënyrë individuale, në çift ose në grup. Bashkëbisedimet janë konfidenciale dhe pa pagesë.

Centre de santé sexuelle-planning familial **Rue Saint-Maurice 4, 2000 Neuchâtel, 032 717 74 35** **planning.familial@ne.ch, www.affaires-sociales-ne.ch**

Orari i pritjes: mundësisht me takim, të hënën, të martën, të premten nga ora 14 deri në orën 18, të mërkurën nga ora 13 deri në orën 19.

Kostoja e shërbimeve: bashkëbisedimet janë falas, kontracepsioni emergjent kushton 12.- CHF dhe testet e shtatzënisë 10.- CHF, për tu diskutuar në rast vështirësie.

Centre de santé sexuelle-planning familial **de La Chaux-de-Fonds et du Locle** **Rue Sophie-Mairet 31, 2300 La Chaux-de-Fonds, 032 967 20 91** **www.chaux-de-fonds.ch/services/planning-familial**

Orari i pritjes: Gjatë orareve tona të permanencës, me ose pa takim. Kontrolli me gjinekologun me takim.

Permanenca: të hënën dhe të mërkurën nga ora 12-18, të martën dhe të premten nga ora 15-18.

Kostoja e shërbimeve: Bashkëbisedimi, kontracepsioni emergjent (pilula e së nesërme) dhe testi i shtatzënisë janë falas, recetat për kontracepsion dhe ekzaminim gjinekologjik janë me tarifa shumë të volitshme:

Më pak se 20 vjeç: 15.- CHF receta dhe 22.- CHF kontrolli gjinekologjik me frottis.

Më shumë se 20 vjeç: 30.- CHF receta dhe 22.- CHF kontrolli gjinekologjik me frottis.

Nëse konfidencialiteti nuk është i nevojshëm, fatura mund t'i dërgohet sigurimit shëndetësor.

Shërbime të specializuara

Qëndrat për kujdesin ndaj fëmijëve të Kryqit të Kuq **Centres de puériculture de la Croix-Rouge**

Qendrat për kujdesin ndaj fëmijëve ofrojnë konsultime për foshnjat dhe fëmijët e vegjël deri në moshën 4 vjeç, si dhe këshilla për prindërit. Infermieret kujdestare që punojnë në këto qendra trajtojnë me prindërit temat e mëposhtme: dhënien e gjirit dhe ndalimin e tij, ushqimin, gjumin, zhvillimin psikomotor, kujdesin dhe edukimin e fëmijës; ato trajtojnë edhe tema që kanë të bëjnë me parandalimin e aksidenteve (dentare, aksidente shtëpiake, etj), me marrëdhëniet dhe veprimet e përbashkëta brënda familjes.

Konsultimet bëhen në disa qytete dhe fshatra të kantonit. Linja telefonike është gjithashtu në dispozicion të prindërve.

➤ **032 886 88 66** Hotline për tërë kantonin,
nga e hëna deri të premten nga ora 8 deri në 9.
puericulture@croix-rouge-ne.ch, www.croix-rouge-ne.ch

➤ **Centre de puériculture de Neuchâtel, Vignoble, Val-de-Ruz et Val-de-Travers**
Avenue du 1^{er} Mars 2a, 2000 Neuchâtel

➤ **Centre de puériculture de La Chaux-de-Fonds et du Locle**
Rue de la Paix 71, 2300 La Chaux-de-Fonds

Orari i pritjes: konsulta pa takim gjatë orareve të caktuara në faqen Internet www.croix-rouge-ne.ch, rubrique «familles et enfants/ puériculture».

Kostoja e shërbimeve: për 4 vitet e konsultave në vijim ose në shtëpi, taksa e regjistrimit në qendër prej 86.- CHF për një fëmijë (129.- CHF për dy binjakë me mundësinë për të shkuar në shtëpi sipas kërkesës), duke përfshirë këtu edhe një kurs hyrës masazhi për fëmijët.



Zyra për mbrojtjen e fëmijës

Office de protection de l'enfant

Zyra për mbrojtjen e fëmijës ofron mbështetje për familjet që përjetojnë vështirësi të tipit edukativ ose social në formën e mandatit ose të ndjekjes vullnetare. Kjo zyrë është gjithashtu edhe një qendër kantonale këshillimi për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me abuzimet ndaj fëmijëve.

> **Office de protection de l'enfant, Équipe des Montagnes**
Rue du Rocher 7, 2300 La Chaux-de-Fonds, 032 889 66 45

> **Office de protection de l'enfant, Équipe Littoral est et Val-de-Ruz**
Faubourg de l'Hôpital 36, 2000 Neuchâtel, 032 889 66 40
www.ne.ch/autorites/DEF/SPAJ/protection-enfant

Kostoja e shërbimeve: falas.

Orari i pritjes: punonjësit në mbrojtje të fëmijës janë në dispozicion të familjeve dhe fëmijëve për konsulta telefonike gjatë orarit të punës.

Shërbime të specializuara

Fondacioni Carrefour, AEMO nga 0 deri 18 vjeç Fondation Carrefour, AEMO

AEMO (Aksion edukativ në një mjedis të hapur) është një shërbim i specializuar për mbështetjen edukative ambulatorë. Ai është i hapur për të gjithë prindërit dhe fëmijët nga 0 deri në 18 vjeç, të cilët hasin vështirësi edukative, relacionale dhe / ose sociale, të cilët kanë nevojë për mbështetje në praktikën e tyre prindërore si dhe në veprimet e jetës së përditshme. Mbështetja është e individualizuar dhe është ndërtuar sipas ritmit të familjes e sipas nevojave të saj. AEMO mundet t'ju ndihmojë në:

- Identifikimin dhe të kuptuarin e nevojave të fëmijës, adoleshentit, për favorizimin e zhvillimit të tij fizik, psiqik, afektiv edhe social.
- Forcimin e aftësive edukative të prindërve.
- Mbështetjen dhe krijimin dhe forcimin e lidhjeve «prind-fëmijë».
- Gjetjen e zgjidhjeve për vështirësitë e përditshme.
- Favorizimin e lidhjeve sociale.

Në krijojmë takime të rregullta në shtëpi ose tek AEMO, një hapësirë fiale për prindin, fëmijën, adoleshentin, gjithnjë duke bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm. Mbështetja jonë është e kufizuar në kohë.

> AEMO Peseux
Place de la Fontaine 4, 2034 Peseux, 032 725 66 50
aemo@ne.ch

> AEMO La Chaux-de-Fonds
Avenue Léopold-Robert 51, 2300 La Chaux-de-Fonds, 032 886 88 99
aemo.cdf@ne.ch, www.fondation-carrefour.net

Kostoja e shërbimeve: Shërbimi nuk kërkon asnjë pjesëmarrje financiare. Ai financohet prej Shtetit të Neuchâtelit, duke bashkëpunuar ngushtë me Zyrën e mbrojtjes së fëmijës.

Orari i pritjes: Me takim.
Linja telefonike gjatë orarit të punës.

Shërbime të specializuara

Shërbimi Psiko-edukativ i Kryqit të Kuq nga 0 - 18 vjeç e sipër **Service Psycho-éducatif de la Croix-Rouge**

Shërbimi Psiko-edukativ (EPS) ofron shërbime të veçanta në shtëpi e pranë familjes, për mbështetjen psiko-edukative të fëmijëve dhe adoleshentëve që përjetojnë probleme të ndryshme.

SPE ofron një ndërhyrje psiko-edukative për familjet që përballen me vështirësitë e integritit, në shtëpinë dhe mjedisin e fëmijës (nga mosha 0 deri 18 vjeç) si dhe të familjes së tij.

Këto situata mund të paraqesin vështirësi të shoqërizimit si dhe probleme të tjera edukative, familjare, shoqërore dhe shkollore ose situata psikosociale të vështira e shqetësuese ashtu si edhe dhunë. Veprimtaria e këtij shërbimi zhvillohet në shtëpi dhe ka si qëllim të punojë me vështirësitë e hasura në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë anëtarët e familjes, duke mobilizuar potencialin dhe burimet që mund të përmirësojnë aftësitë e saj si dhe duke favorizuar të gjitha mundësitë e saj.

Intervenimet mund të zhvillohet disa herë në javë në duo dhe / ose vetëm me edukatorin apo psikologun, në kohë të ndryshme ose njëkohësisht.

Puna bëhet në lidhje të ngushtë me OPE (Zyrën për mbrojtjen e fëmijës), duke përmbushur kërkesat e konceptit psiko-edukativ ashtu si edhe udhëzimet e Kryqit të Kuq.

> **Service Psycho-éducatif, Soutien familial et aide à l'intégration**
Croix-Rouge Suisse - Canton de Neuchâtel
Site de La Chaux-de-Fonds
Rue de la Paix 71, 2300 La Chaux-de-Fonds, 032 886 88 60
www.croix-rouge-ne.ch/accueil/familles-et-enfants/psycho-educatif/

Kostoja e shërbimeve: Asnjë kontribut financiar nuk u kërkohet familjeve. Shërbimet financohen nga autoritetet publike (Departementi i arsimit dhe i familjes nëpërmjet Shërbimit të mbrojtjes të të rriturve dhe rinisë).

Orari i pritjes: Linjat telefonike gjatë orarit të punës.

Shërbime të specializuara

Shërbimi Edukativ Shëtitës Service Éducatif Itinérant, SEI

Shërbimi SEI ofron një mbështetje për Arsimin e Hershëm të Specializuar në kontekstin familiar, për të gjithë fëmijët nga 0 deri në 6 vjeç që paraqesin një handicap, një zhvillim të vonuar si dhe për ata fëmijë, zhvillimi i të cilëve është i kompromentuar ose i kufizuar. Arsimi i Hershëm i Specializuar mbulon ansamblin e gjithë veprimtarisë arsimore e pedagogjike me qëllim që të përmirësojë potencialin e zhvillimit të fëmijëve të vegjël. Shërbimi Edukativ Shëtitës i mbështet prindërit dhe u propozon, në kushtet e shtëpisë ku jeton fëmija, një vlerësim, marrje masash parandaluese dhe edukative ashtu si edhe një stimulim adekuat. Shërbimi SEI është pjesë e Fushës së Kompetencës «Shkollat e specializuara» të fondacionit «les Perce-Neige».

> SEI, Service Éducatif Itinérant
Saars 131, 2000 Neuchâtel, 032 710 15 02
anne-lise.butscher@ne.ch

Kostoja e shërbimeve: Zyra e Mësimdhënies së Specializuar (L'Office de l'Enseignement Spécialisé) merr vendime për t'i drejtuar tek Arsimi i Hershëm i Specializuar (Education Précoce Spécialisée) ky shoqërim është gratis për familjet. Kërkesa e prindërve mund të mbështetet nga mjekët, terapistët, mësuesit, asistentët sociale, etc.

Orari i pritjes: Merret kontakt nëpërmjet telefonit.



Qëndra psikomotorike **Centre de psychomotricité**

Qendra psikomotorike është qendra kantonale e shqyrtimit, parandalimit dhe e terapisë psikomotorike për fëmijët dhe të rinjtë që banojnë në kanton që nga moshë 0 deri në 18 vjeç. Terapia psikomotorike është për njerëzit e të gjitha moshave që paraqesin vështirësi komunikimi, të shprehuri dhe veprimi, të cilat mund të manifestohen edhe fizikisht. Lokalet e konsultimit janë të shpërndara në të gjithë territorin e kantonit.

> **Centre de psychomotricité**
Secrétariat, Rue de l'Écluse 67, 2000 Neuchâtel, 032 889 49 64
<http://www.ne.ch/autorites/DEF/SEEO/enseignement-specialise/Pages/psychomotricite.aspx>

Kostoja e shërbimeve: Zyra e mësimdhënies së specializuar ka marrë kriteret e vjetra të AI (sigurimit të invaliditetit) duke marrë kështu në ngarkesë financiarisht trajtimet e fëmijëve që u përgjigjen këtyre indikacioneve: <http://www.ne.ch/autorites/DEF/SEEO/enseignement-specialise/Pages/psychomotricite.aspx>.

Për fëmijët e tjerë, qendra psikomotorike kërkon nga prindërit, që prej 1 janarit 2014, një pjesëmarrje prej 24.- CHF për një çerek ore, të plotë ose të pjesëshme.

Orari i pritjes: me takim, gjatë periudhës së vitit shkollor. Prindërit mund të marrin kontakt direkt me qendrën. Sinjalizimet ose raportet e bëra nga ndërmjetësit kërkojnë pëlqimin e prindërve.

Shërbime të specializuara

Qëndra psikiatrike e Neuchâtelit – Fëmijëria dhe Adoleshenca **Centre Neuchâtelois de psychiatrie – Enfance et adolescence (CNPea)**

Departamenti i psikiatrisë së fëmijës dhe adoleshentit në Qëndrën psikiatrike të Neuchâtelit është për fëmijët nga 0 deri në 18 vjeç si dhe për familjet e tyre. Qendra ofron një gamë të gjërë trajtimesh dhe kujdesi për fëmijët dhe adoleshentët me probleme mendore. Atje bëhen konsultime mjekësore dhe psikologjike nga ekipe të specializuara për fëmijët e vegjël nga 0 deri në 6 vjeç dhe për familjet e tyre, për gratë shtatzëna në vështirësi si dhe për bashkëshortët e tyre. Vlerësim dhe kujdes specifik për fëmijët e vegjël, përkrahje prindërore.

> CNP Enfance et adolescence
Développement et guidance infantile
Place des Halles 8, 2000 Neuchâtel, 032 889 69 13
ea-ln2.ca@cnp.ch

> CNP Enfance et adolescence
Rue du Parc 117, 2300 La Chaux-de-Fonds, 032 889 69 66
ea-mn.ca@cnp.ch

Kostoja e shërbimeve: Këto shërbime merren në ngarkim nga sigurimi shëndetësor bazë LAMal.

Orari i pritjes: Me takim.
Shërbimi telefonik gjatë orarit të punës.



Shërbimet në ndihmë të familjeve të emigruara Prestations à l'intention des familles migrantes

Rrjeti i nënave të kontaktit (Réseau mères de contact)

Rrjeti i nënave të kontaktit është një projekt i iniciuar nga Departamenti i kohezionit multikulturor dhe Kryqit të Kuq. Ai u drejtohet veçanërisht nënave me fëmijë të vegjël të sapoardhur në kanton dhe / ose atyre që janë të izoluara nga ana sociale. Ky rrjet u ofron një moment të privilegjuar shkëmbimi dhe dëgjimi me gratë e tjera që ndajnë të njëjtat shqetësime. Këto takime mes nënës së re dhe «nënës së kontaktit» janë një mundësi për ta informuar atë mbi çështjet shëndetësore, mbi arsimin dhe mënyrën e jetesës në kanton.

➤ **Réseau mères de contact**
Croix-Rouge Suisse – Neuchâtel
Avenue du 1^{er} Mars 2a, 2000 Neuchâtel, 032 886 88 60
www.croix-rouge-ne.ch

RECIF

RECIF është një shoqatë që i drejtohet çdo gruaje, qoftë e huaj apo zvicerane, që kërkon një vend takimi të favorshëm për shkëmbimet, që dëshiron të fitojë njohuri praktike për të lehtësuar integrimin e saj, që dëshiron të krijojë kontakte miqësore dhe sociale. RECIF angazhohet edhe në fushën e shëndetit dhe propozon aksione për parandalimin dhe ndërgjegjësimin ndaj çështjeve që lidhen me shëndetin në përgjithësi, duke bërë lidhjen me rrjetin ekzistues shëndetësor në rajonin e Neuchâtel-it. Po ashtu, në kurset e frëngjishtes që ofron RECIF, një herë në muaj përfshihen edhe ekspertë të shëndetësisë. Hapësira për fëmijët e RECIF-it mirëpret fëmijë nga moshë 4 muaj deri në 6 vjeç në kohën kur kur nëna e tyre ndjek kurset e gjuhës frënge. Ajo organizon po ashtu, aktivitete prind-fëmijë.

➤ **RECIF**
Rue de la Cassarde 22, 2000 Neuchâtel, 032 730 33 50
2000@recifNE.ch, www.recifne.ch

➤ **RECIF**
Rue du Doubs 32, 2300 La Chaux-de-Fonds
2300@recifNE.ch, www.recifne.ch, 032 968 62 42

Pranimi dhe shërbimet për kujdesin ndaj fëmijës

Shërbimi i Ruajtjes së Fëmijëve në Shtëpi i Kryqit të Kuq Service Garde d'Enfants à Domicile de la Croix-Rouge (GED)

Shërbimi i Ruajtjes së Fëmijëve në Shtëpi vjen të lehtësojë dhe të mbështesë prindërit e fëmijëve të moshës nën 12 vjeç, kur ata janë të sëmurë ose kur për shkak të një vështirësie, kanë nevojë për një kujdestari të përkohshme. Kjo ndodh kur prindërit duhet të punojnë dhe nuk dinë se kujt t'ia besojnë fëmijën e tyre të sëmurë, kur vetë ata janë të sëmurë apo kalojnë një situatë të vështirë, ose në një rast të veçantë kur ata nuk kanë mundësi të përdorin sistemin e tyre të zakonshëm për ruajtjen e fëmijës. Kujdestarët e Kryqit të Kuq që shkojnë t'i ruajnë fëmijët në shtëpi janë të formuar nga Kryqi i Kuq dhe kanë përvojë të gjatë.

> Service de Garde d'Enfants à Domicile Croix-Rouge Suisse - Canton de Neuchâtel 032 886 88 65

Kostoja e shërbimeve: sipas të ardhurave bruto të familjes. Një shumë prej 20.- CHF është paraparë gjithashtu për shpenzimet e udhëtimit (pa harruar tarifat e parkimit). Në rast problemi financiar ose për më shumë informacione, duhet të kontaktoni Kryqin e Kuq.

Orari i pritjes: Merrni kontakt nëpërmjet telefonit nga e hëna deri të premten prej orës 8:00 deri në 12:00 (në rast emergjence edhe pasditeve, nga ora 14:00 deri në 17:00).



Pranimi dhe shërbimet për kujdesin ndaj fëmijës

Qëndra e pranimit prindër fëmijë

Lieux d'accueil enfants parents

La Courte Échelle dhe la Trottinette janë qendra pranimi, takimi, shkëmbimi dhe zbavitje që janë të hapura për fëmijët e porsalindur deri në moshën 4 ose 5 vjeçare, të shoqëruar nga njëri prej prindërve ose nga një i rritur që ata e njohin mirë.

Fëmijët dhe prindërit do të gjejnë një hapësirë jetese ku fjala qarkullon dhe lejon, pa detyrim, të shprehin atë që zbulojnë, atë që përjetojnë çdo dite, atë që i vë në pyetje. Fëmijët, në prani të njërit prej prindërve të tyre që u jep siguri, eksperimentojnë jetën në grup dhe zhvillojnë besimin dhe respektin ndaj vetes.

> La Courte Échelle

Rue des Fausses-Brayes 3, 2000 Neuchâtel, 032 724 45 15
info@lacourteechelle.ch, www.lacourteechelle.ch

Kostoja e shërbimeve: çmimi i synuar: 3.- CHF për familje.

Orari i pritjes: Mundësia për të ardhur sipas dëshirës, pa regjistrim paraprak, sipas orareve në dispozicion në faqen e internetit.
Fëmijët janë të mirëpritur deri në moshën 5 vjeçare.

> La Trottinette

Rue de la Serre 24, 2300 La Chaux-de-Fonds, 032 914 52 60
latrottinette@bluewin.ch, www.association-la-trottinette.ch

Kostoja e shërbimeve: çmimi i synuar: 3.- CHF minimum (mundësi për të marrë ndihmë nga Pro Juventute).

Orari i pritjes: Mundësia për të ardhur sipas dëshirës, pa regjistrim paraprak, sipas orareve në dispozicion në faqen e internetit.
Fëmijët janë të mirëpritur deri në moshën 4 vjeçare.

Pranimi dhe shërbimet për kujdesin ndaj fëmijës

Qendra ditore **Accueil de jour**

Në kanton ka mundësi të shumta për prindërit ose për prindërit e ardhshëm që janë në kërkim të një zgjidhje për fëmijën (t) e tyre.

> **Struktura të kujdesit ndaj fëmijëve jashtë familjes**

Të gjitha informatat e nevojshme mund t'i gjeni në faqet Internet të (Office de l'accueil extrafamilial (OAEF)
www.ne.ch/accueilextrafamilial

> **Kujdes familiar ditor**

Të gjitha informatat e nevojshme mund t'i gjeni në faqet Internet të (Office de l'accueil extrafamilial (OAEF)
www.ne.ch/accueilextrafamilial
ou sur www.mamansdejour.ch

> **Shërbimi për mbajtjen e fëmijës në shtëpi i Kryqit të Kuq** Lutemi t'i referoheni informacionit që figurons në faqen 15.

> **Shërbimi baby-sitting i Kryqit të Kuq**

Kryqi i Kuq ofron gjithashtu një shërbim prej baby-sitting, nga të rinj që kanë kryer me sukses formacionin e dhënë prej tij. Prindërit e interesuar mund t'i drejtohen shërbimit baby-sitting që do ti vërë në kontakt me një baby-sitter.

Service de baby-sitting Croix-Rouge, 032 886 88 65
www.croix-rouge-ne.ch

Adresa dhe lidhje të tjera të dobishme

A dresa dhe lidhje të tjera të dobishme

- **Shoqata Arsimi të jep Forcë-NE**
Association L'Éducation donne de la Force-NE
Rrjeti Arsimi të jep Forcë-NE regrupon shoqata të ndryshme, institucione, organizma dhe trajnerë aktivë në mbështetje të prindërve. Një prezantim dhe kontakte me seicilin prej antarëve të tij mund ta gjeni në faqen Internet: www.edf-ne.ch
- **Mesazh për prindërit nga Pro Juventute**
Messages aux parents de Pro Juventute
Mesazhe drejtuar prindërve nga Projuventute janë në dispozicion në faqen e internetit www.projuventute.ch/Messages-aux-parents. Ato përmbajnë informacione praktike mbi edukimin, të drejtat e fëmijës dhe shëndetin.
- **Bota e shëndetit**
Planète santé
Faqja internet me informacione mbi shëndetin, përmbajtja e së cilës është vlerësuar nga mjekët frankofonë. Faqe e pavarur e industrisë dhe e sigurimeve.
www.planetesante.ch

Kjo broshurë është realizuar me iniciativën e:

Shërbimi i shëndetit publik (Service de la santé publique)

Shërbimi i shëndetit publik është aktiv në fusha të ndryshme të vënies në jetë të politikës kantonale të shëndetit, duke përfshirë edhe atë të parandalimit dhe promovimit të shëndetit. Në këtë kontekst, programe të ndryshme dhe aktivitete për fëmijët e moshave të hershme janë në vazhdim.

Service de la santé publique

Mme lysiane Ummel Mariani, déléguée à la promotion de la santé
Rue Pourtalès 2
2000 Neuchâtel
032 889 52 19
www.ne.ch/promotionsante
lysiane.mariani@ne.ch

Në bashkëpunim me:

Zyra e pranimit në ndihmë të familjes (L'Office de l'accueil extrafamilial)

Zyra e pranimit në ndihmë të familjes ka si mision të lejojë, monitorojë dhe këshillojë të gjitha strukturat e pranimit të fëmijëve të vendosura në to dhe të sigurojë mbrojtjen e tyre.

Office de l'accueil extrafamilial

Mme Christine Schurch Blant, cheffe d'office
Faubourg de l'Hôpital 34-36
2000 Neuchâtel
032 889 66 34
www.ne.ch/accueillexfamilial

I deleguari për rininë (Le Délégué à la jeunesse)

I deleguari për rininë është përgjegjës për zbatimin e politikës kantonale të të rinjve. Roli i tij është të sensibilizojë publikun, sidomos të rinjtë, mbi të drejtat e fëmijëve si dhe të jetë në dispozicion për informacione dhe këshilla.

Délégué à la jeunesse

M. Alex Pedrazzi
Faubourg de l'Hôpital 34
2000 Neuchâtel
032 889 85 41
www.ne.ch/autorites/DEF/SPA

Një problem shëndetësor? Kompozoni numrin e saktë:



Urgjenca **144**



Shërbimi roje :
Mjeku
Farmacisti
Dentisti

0848 134 134



+ Shërbimi telefonik
i peditrisë :

032 713 38 48

ne.ch

Numra të tjerë të urgjencës

Qendra zvicerane e informacionit mbi toksikologjinë
Centre Suisse d'information Toxicologique: **145**

Zyra e mbrojtjes së fëmijës: Office de protection de l'enfant
Ekipi i Maleve, **032 889 66 45**

Ekipi i Littoralit dhe Val-de-Ruz, **032 889 66 40**